Kronikë

Pogradec/ Kultivim bimësh narkotike dhe municion luftarak me vete, policia arreston 31 vjeçarin (EMRI)

Një rast i kultivimit të bimëve narkotike është goditur në Pogradec. Policia ka arrestuar një 31 vjeçar, të cilit iu gjet dhe një municion luftarak.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
8 Gusht, 15:36 | **Përditesimi: 8 Gusht, 15:46**

Share

POGRADEC - Goditet një rast i kultivimit të bimëve narkotike në Pogradec.

Policia ka arrestuar një 31 vjeçar pasi në fshatin Tallë në vendin e quajtur 'Uji i Ftohtë', dyshohet se kishte kultivuar 610 bimë narkotike, të cilat u asgjësuan me anë të djegies.

> *'Në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional kombëtar "Territor i pastër", për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, shërbimet e Komisariatit të Policisë Pogradec kanë intensifikuar kontrollet në terren, duke u bazuar në inteligjencën policore. Si rezultat i kontrolleve, në vendin e quajtur "Uji i Ftohtë", në fshatin Tallë, u gjetën të kultivuara 610 bimë narkotike cannabis sativa, të cilat u asgjësuan me anë të djegies.'*

[Sh.com]
LEXO EDHE:
Plagosi me kaçavidë vëllanë pas sherrit për pronësi në Pogradec, kapet pas një viti kërkime 45-vjeçari

Më tej gjatë kontrollit në territor policia gjeti 1 armë gjahu dhe municion ushtarak të cilat u sekuestruan.

Policia arrestoi Danjel Skënderi, 31 vjeç banues në Divjakë në fshatin Çermë-Sektor.

> *'Gjatë kontrollit të territorit, u gjetën dhe 1 armë gjahu dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me 2 celularë.*
> *Në vjim të veprimeve për këtë rast u arrestua në flagrancë shtetasi D. S., 31 vjeç, banues në fshatin Çermë-Sektor, Divjakë.'*

Ai është në hetim për kultivim të lëndëve narkotike dhe prodhim dhe armëmbajtje pa leje.

G.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: pogradec | divjakë | bimë narkotike

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh.com]
Sondazhi i ditës:
Ku po i kaloni pushimet e verës?

Në Shqipëri | Jashtë | Nuk lëviz

Lajme të tjera

PAMJET/ Karambolohen dy makina në Qafë Thanë, plagosen 2 shoferët dhe 3 pasagjerët
7 Gusht, 14:28

Merr flakë bombola e gazit në një banesë në Pogradec, plagoset 71-vjeçarja! Nga shpërthimi, dritaret e apartamentit përfunduan në rrugë
7 Gusht, 10:49

Rritet fluksi i udhëtarëve në pikën kufitare të Qafë-Thanës në Pogradec! Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut dhe turistët e huaj drejt plazheve të Jugut
Armand Braho
6 Gusht, 16:52

Nga Pogradeci në Ulqin, piktori Sadik Kasa e feston 70-vjetorin me ekspozitën shëtitëse në trojet shqipfolëse
Armand Braho
5 Gusht, 10:08

Pogradec/ Organizohet për herë të parë festivali i peshkatarëve! Ekspozim produkteve dhe argëtim
Armand Braho
3 Gusht, 14:57

Eduard Zaloshnja: Pogradeci, Mbret i turizmit vendas
Eduard Zaloshnja
3 Gusht, 14:18

Lejoi ndërtimet pa leje, kryeinspektori i Bashkisë së Divjakës dënohet me 1 vit burg
3 Gusht, 10:20

'Frymë vere', instrumentistët e TKOB koncert në Pogradec
30 Korrik, 20:49

Pogradec/ Sherr me thika midis dy të miturve! 15 vjeçari përfundon në spital
28 Korrik, 22:20

Sherr me thika mes dy të rinjve në Pogradec, një i plagosur! Arrestohet 24-vjeçari
27 Korrik, 22:41

Video/ Maratona e pazakontë në Pogradec, bebushët arrijnë të kapin këmbadoras vijën e finishit
Armand Braho
27 Korrik, 15:57

FOTO/ Këmbët arkeologjike nënujore në Lin të Pogradecit, Rama: Brenda vitit e shpallim zonë të mbrojtur arkeologjike
27 Korrik, 15:55

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje